



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2023:297827

Datë: 26.11.2024

Numri i dokumentit: 06506380

C.nr.3378/23

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtarja Edona Zuzaki, me bashkëpunëtoren profesionale Bionda Rexhepi, në çështjen juridike kontestimore të paditëses F.S., nga Gjilani, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson T.I., avokat nga Prishtina, kundër të paditurës Ministria e Punëve të Brendshme - Policia e Kosovës, me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson Avokatura Shtetërore, me objekt kontesti kompensimi i shpërblimit për pagat mujore ekuivalente me pagën e fundvitit, me vlerë të kontestit 1,060.5 euro, jashtë seance gjyqësore, më datë 26.11.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APPROVOHET pjesërisht e bazuar kërkesëpadia e paditëses F.S., nga Gjilani dhe DETYROHET e paditura Ministria e Punëve të Brendshme - Policia e Kosovës, me seli në Prishtinë, që në emër të shpërblimit të pagave të rregullta mujore në fund të vitit 2020, t'ia paguaj paditëses shumën prej 530.25 euro, me kamatë ligjore prej 8 % nga data 26.12.2023, si datë e paraqitjes së padisë, e deri në pagesën definitive, në afat prej 7 ditë, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën pasojat e përmbarimit ligjor.

II. REFUZOHET pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditëses, me të cilin ka kërkuar që të detyrohet e paditura që t'ia kompensojë edhe pagën e rregullt mujore në fund të vitit 2019 në shumën prej 530.25 euro.

III. DETYROHET e paditura, që paditëses t'ia paguaj shpenzimet e procedurës në shumën e përgjithshme prej 125.00 euro, në afat prej 7 ditë, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën pasojat e përmbarimit ligjor.

A r s y e t i m

Paditësja, përmes të autorizuarit të saj, më datë 26.12.2023, ka paraqitur padi në këtë gjykatë, kundër të paditurës, për kompensimin e shpërblimit për pagat mujore ekuivalente me pagën e fundvitit, në vlerë prej 1,060.5 euro.

Në padi ka theksuar se paditësja është në marrëdhënie pune te e paditura në pozitën e punës Zyrtar Policor pranë DRP në Gjilan, ndërsa bazuar në nenin 29 të Udhëzimit Administrativ Nr.02/2018 mbi

Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës të datës 14.11.2018, të njëjtit i takon shpërblimi për pagat mujore ekuivalente me pagën e fundvitit për shkak të vlerësimit të kënaqshëm dhe mungesës së masave disiplinore. Për realizimin e këtyre të drejtave, ka theksuar se i është drejtuar të paditurës me kërkesë, mirëpo e njëjta është refuzuar me arsyetim të mungesës së mjeteve financiare. Gjykatës i ka propozuar që të apurojë të bazuar kërkesëpadinë e paditëses dhe të detyrojë të paditurën në kompensimin e shpërblimeve të pagave të fundvitit për vitin 2019 dhe 2020¹, në shumën e përgjithshme prej 1,060.5. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar në mënyrë të specifikuar: 104.00 euro, për përpilim të padisë dhe 21.00 euro, për taksë gjyqësore.

E paditura në përgjigje në padi ka deklaruar se e kundërshton në tërësi të pabazuar kërkesëpadinë e paditëses, duke theksuar se paga e trembëdhjetë mund të realizohet vetëm në momentin e aprovimit të buxhetit nga Ministria e Financave, për të cilin Ministria e Punëve të Brendshme - Policia e Kosovës ka bërë kërkesë për buxhet shtesë dhe i është refuzuar nga e njëjta. Ka konsideruar se kërkesa e paditëses është e parashkruar në bazë pasi është parashtruar pas më tepër se 3 vite. Më tej ka theksuar se paditësja është punësuar pranë të paditurës më datë 11.11.2019, prandaj nuk i plotëson kushtet për kompensimin e pagës së 13-të, për këtë vit, ndërsa në vitin 2021 të njëjtit i është shqiptuar masë disiplinore. Gjykatës i ka propozuar të refuzojë të pabazuar kërkesëpadinë e paditëses. Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

Gjykata pas pranimit të përgjigjes në padi ka konstatuar se janë plotësuar kushtet ligjore për marrjen e aktgjykimit jashtë seance gjyqësore, bazuar në nenin 398 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), në të cilin është përcaktuar se “Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilin e pranon si të themeltë kërkesëpadinë” dhe 399.1 që përcakton se “Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadsë, atëherë ajo do të jep vendimin meritor me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadia”.

Gjykata ka gjetur se mes palëve nuk është kontestues fakti se paditësja është i punësuar me orar të plotë në Policinë e Kosovës që nga data 11.11.2019 (vërtetimi nr.ref.05/3-06/SRR/0864/2023, dt. 04.10.2023), për periudhën 2019 dhe 2020 është vlerësuar me vlerësim plotësisht të kënaqshëm (formulari i vlerësimit të performancave për këto 3 vite) dhe është paguar në shumën prej 530.25 euro në muaj (vërtetimi si më lartë).

Gjykata bazuar në nenin 329.1 të LPK-së, provat në shkresat e lëndës i gjeti vendimtare për vendosje në këtë çështje meritore, pasi të njëjtat janë lëshuar nga organi shtetëror – këtu vet e paditura, brenda kufijve të kompetencës së vet, duke provuar saktësinë e thënieve në këto dokumente.

¹ Në petitum të kërkesëpadsë është lëshuar një gabim teknik duke u shënuar viti 2021 në vend të vitit 2020, ndërsa nga thëniet në padi dhe provat në shkresat e lëndës kuptohet se kërkohet kompensimi për vitin 2020.

Nga kjo gjendje faktike e vërtetuar, gjykata gjeti se themelësia e kërkesëpadisë, e aprovuar si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi del bazuar në dispozitat e nenit 55, paragrafi 1 të Ligjit të Punës që përcakton se “I punësuar ka të drejtë në pagë, e cila përcaktohet me Kontratën e Punës, në pajtim me këtë ligj, Kontratën Kolektive, Aktin e Brendshëm të Punëdhënësit”; nenin 44, paragrafi 2 të Ligjit për Policinë që përcakton se “Marrëdhënia e punës për personelin policor rregullohet me akt nënligjor”; nenin 55, paragrafi 1, nënparagrafi 1.7 se “Drejtori i Përgjithshëm nxjerr aktet nënligjore për marrëdhënien e punës, siç përshkruhet në paragrafin 2. të nenit 44 të këtij ligji”, e lidhur me Udhëzimin Administrativ Nr. 02/2018 mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës (dt.14.11.2018), që në nenin 5, paragrafi 2 përcakton se “Në polici janë të punësuar tri kategori të personelit policor”; pika 2 e këtij se “Stafi civil, i cili punësohet në Polici për të kryer shërbime mbështetëse dhe administrative”; si dhe nenin 29, paragrafi 2 se “Personelit të Policisë të cilët kanë marrë vlerësim të kënaqshëm dhe të cilët nuk kanë qenë subjekt i shqiptimit të ndonjë mase disiplinore brenda vitit përkatës, do të përfitojnë si shpërblim një pagë mujore ekuivalente me pagën e rregullt mujore në fund të vitit”.

Zbatimi i këtyre dispozitave është në përputhje edhe me Mendimin Juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës, nr.213/2023 të dt.09.10.2023.

Në rastin konkret gjykata gjeti se e paditura ka pasur për detyrim që paditëses si i punësuar pranë saj që të ia paguaj pagën e 13-të për çdo fundvit, pasi që janë plotësuar edhe kushtet nga ana e paditëses siç parashihen në nenin 29 paragrafi 2 të Udhëzimit Administrativ Nr.02/2018, i datës 14.11.2018, më saktësisht, vlerësimi i performancës për vitin 2020, e po ashtu ndaj të njëjtit nuk është shqiptuar asnjë masë disiplinore.

Meqë e paditura është thirrë në parashkrim, gjykata vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, bazuar në nenin 87 të Ligjit të Punës që përcakton se “Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”.

Gjykata vlerëson se në rastin konkret gjen zbatim neni 87 i LP-së, pasi kërkesa e paditëses është kërkesë monetare, e cila është paraqitur më datë 26.12.2023, ndërsa parashkruhet prej 3 vite nga data e paraqitjes së kërkesës, kurse kërkesa e paditëses është për periudhën kohore 2019 dhe 2020, pra për periudhë pjesërisht të përfshirë në parashkrim, prandaj pjesën e përfshirë në parashkrim (vitin 2019), gjykata e refuzoi të pabazuar.

Meqenëse gjykata e refuzoi pagën e 13-të, për vitin 2019 për shkak të parashkrimit, nuk u lëshua në pretendimet e tjera të të paditurës për periudhën e punësimit së paditëses.

Gjykata për kamatën ka vendosur duke u bazuar në dispozitën e nenit 382 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve.

Lidhur me pretendimet e të paditurës të dhëna në përgjigje në padi se të njëjtit nuk kanë mjete financiare për pagesën e kërkuar nga paditësja, për gjykatën një pretendim i tillë është jo relevant

pasi që drejtat e kërkuara nga pala paditëse janë të parashikuara në udhëzimin administrativ, ndërsa e paditura në cilësinë e punëdhënësit duhet t'i përmbush obligimet që ka ndaj punëtorëve.

Sa i përket pretendimit të të paditurës se paditëses i është shqiptuar masë disiplinore për vitin 2021, gjykata vlerëson se viti 2021 nuk është objekt shqyrtimi i kësaj kërkesë, prandaj të njëjtin pretendim nuk e shqyrtoi fare.

Gjykata vendosi si në pikën III të dispozitivit të këtij aktgjykimi, bazuar në dispozitat ligjore nga neni 449, 452, 453 dhe 463 të LPK-së, duke marrë parasysh suksesin e paditëses në këtë procedurë dhe kërkesën e specifikuar për këto shpenzime, ndërsa sa i përket lartësisë së shpenzimeve të procedurës u bazua në nr. tarifor 6 dhe 7 të Rregullorës për Tarifën e Avokatëve të Kosovës.

Nga të lartëcekurat, bazuar në nenin 143, paragrafi 1 lidhur me nenin 398 dhe 399 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
Departamenti i Përgjithshëm/Divizioni Civil
C.nr.3378/23, më datë 26.11.2024

Gjyqtarja,
Edona Zuzaki

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej 7 ditë, nga dita e pranimi në Gjykatën e Apelit, përmes këtij Gjykate.